



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 45 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 02/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i rekomandohet që ta ndryshoj memorandumin e mirëkuptimit të lidhur në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Gjilanit për transfer të mjeteve financiare në vlerë prej 15.000 Euro nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në buxhetin e Kuvendit Komunal të Gjilanit.
2. Ndryshimi të bëhet në neni 2, pika 2 të memorandumit, në mënyrë që pagesa të mund t'i bëhet drejtpërdrejt organizatës kontraktuese.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 03/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Formohet Komitetit Drejtues për përmirësimin në menaxhimin e financave publike, në përputhje me vendimin e Qeverisë Nr. 03/37, të datës 25 shtator 2008, duke përfshirë personat në vijim:
  - 1) Bedri Hamza - Zëvendësministër i MEF-it
  - 2) Besnik Osmani - Sekretar i Përhershëm i MAPL-ës
  - 3) Hajdin Ramadani - Sekretar i Përhershëm i MSHP-ës
  - 4) Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit qendror
  - 5) Lulëzim Ismajli - Drejtor i Thesarit
  - 6) Driton Qehaja - Zyra e Kryeministrit
  - 7) Mimoza Gojani - Zyra e Kryeministrit
  
2. Komiteti Drejtues do të vendosë termat e referencës për projektin e përmirësimit të financave publike, të cilat do të jenë në përputhshmëri me vendimin e Qeverisë Nr. 03/37, të datës 25 shtator 2008.
  
3. Komiteti Drejtues do ta formojë sekretariatit në përputhshmëri me termat e referencës.

4. Komiteti Drejtues do të formojë grupet e punës, në të cilat do të marrin pjesë përfaqësues të ministrive dhe të agjencive të ndryshme, për të ndihmuar në përgatitjen e planit të veprimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, si dhe vendimit të Qeverisë Nr. 07/31 të datës 27.08.2008, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Bazuar në rekomandimet e komisionit për shqyrtim të ofertës së Postë-Telekomunikacionit të Kosovës (PTK Sh. A.) autorizohet Ministria e Shërbimeve Publike që të negociojë detajet e ofertës lidhur me ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile.
2. Ministria e Shërbimeve Publike do të udhëheqë të gjitha procedurat e nevojshme konform ligjeve në fuqi.
3. Ngarkohet Ministria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 05/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Ligjit të Aplikueshëm mbi Eksproprijimin Nr. 011-3/1-1978, i datës 17 mars 1978, Ligjit për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimorë "Adem Jashari" në Prekaz me Interes të Veçantë Nacional Nr. 2004/39, si dhe nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Përcaktohet interesi i përgjithshëm për ngastrat kadastrale të patundshme sipas tabelës së parcelave të paraqitura në aneks, bashkangjitur këtij vendimi.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Skenderajt që të realizojë procedurat për eksproprijim dhe kompensim të parcelave tokësore konform Ligjit për Eksproprijim GZ-21/1978, GZ- Nr. 46/86 dhe dispozitave tjera të aplikueshme në fuqi për ngastrat kadastrale sipas aneksit të prezantuar.
3. Kompensimi i ngastrave kadastrale sipas aneksit të këtij vendimi do të bëhet në bazë të vendimit Nr. 15/119, të datës 03.11.2004 të Qeverisë së Kosovës, mbi aprovimin e kriterëve për vlerësimin e pronës dhe pasurisë së banorëve të fshatit Hade.
4. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Kuvendi Komunal i Skenderajt për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Kostoja e gypave të ujësjetësit						
Nr.	Emri & Mbiemri	Nësia	Sasia	Gjatësia	Çmimi për m' në €	Shuma në €
1	Ismajl Jashari	Copë	2 nga 135m'	270	15	4,050.00
2	Dibran Jashari	Copë	1	135	15	2,025.00
3	Milazim Jashari	Copë	1	140	15	2,100.00
4	Muhamet Jashari	Copë	1	130	15	1,950.00
5	Xhafer Jashari	Copë	2 nga 50m'	100	15	1,500.00
Totali					775	11,625.00

Kostoja për Tokën								
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Fleta Poseduse	Ngastra	Klasa	Sipërfaqja e Përgjithshme	I mirret	Sipërfaqja e shprehur në m²	Çmimi në € për m²
1	Hajriz Ali Lushaku	52	645	II	00.28,41 ha	00.28,41 ha	2841	4.75
2	Bislim Zeqir Jashari Rifat Shaban Jashari	118	619/1	II	00.11,56 ha	00.11,56 ha	1156	4.75
3	Rrahim Hashim Lushaku	73	644	II	00.21,79 ha	00.21,79 ha	2179	4.75
4	Hamide Islam Lushaku	157	645/1	II	00.25,30 ha	00.25,30 ha	2530	4.75
Gjithësejt					00.87,06 ha	00.87,06 ha		

Kostoja e drunjëve							
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Fleta Poseduse	Ngastra	Klasa	Sipërfaqja e Përgjithshme	I mirret	vlera
1	Hajriz Ali Lushaku	52	645	II	00.28,41 ha	00.28,41 ha	15,375.49
2	Rifat Shaban Jashari	118	619/1	II	00.11,56 ha	00.11,56 ha	1,200.00
3	Rrahim Hashim Lushaku	73	644	II	00.21,79 ha	00.21,79 ha	8,844.56
4	Hamide Islam Lushaku	157	645/1	II	00.25,30 ha	00.25,30 ha	10,269.27
Gjithësejt							35,689.32

Kostoja e përgjithshme	
1 Kostoja e Tokës	41,353.50
2 Kostoja e Gypave	11,625.00
3 Kostoja e drunjëve	35,689.32
Totali	88,667.82





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR. 03/15**

1. Paragrafi 2. i vendimit të Qeverisë Nr. 03/15 i datës 10.04.2008, zëvendësohet në tërësi me tekstin në vijim:

“Mjetet financiare në shumën 8,000.00 (tetëmijë) Euro për realizimin e projektit sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të transferohen nga kodi 005 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë bankare të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – dega në Rahovec, Nr. 1205001010210659 NLB Bank”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/46

Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Themelohet Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve.
2. Komiteti Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve themelohet për të komunikuar dhe koordinuar politikat, programet dhe proceset në lidhje me çështjet e të drejtave të fëmijëve ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe për të lehtësuar realizimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe me qëllim për të mbrojtur, nxitur dhe avancuar të drejtat e fëmijëve në Kosovë.
3. Komiteti do të ketë këtë përbërje:
  - 1) Kryeministri i Kosovës - kryesues
  - 2) Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale
  - 3) Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
  - 4) Ministri i Shëndetësisë
  - 5) Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
  - 6) Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal
  - 7) Ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit
  - 8) Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave
  - 9) Ministri i Ministrisë së Drejtësisë
  - 10) Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme
  - 11) Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë - ZKM
  - 12) Kryesuesi i Zyrës së UNICEF-it në Kosovë
  - 13) Forumi për të Drejtat e Fëmijëve (3 përfaqësues)

4. Komiteti ka mandatin e përcaktuar sipas kushteve të parashtruara, bashkangjitur këtij vendimi.
5. Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit do të shërbejë si sekretariat për të zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e Komitetit.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/46

Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuar.
  
2. Këshilli ka këtë përbërje:
  - 1) Ramë Manaj - zëvendëskryeministër i Kosovës - kryesues
  - 2) Halit Ferizi - Handikos (aftësia e kufizuar fizike) - bashkëkryesues
  - 3) Habit Hajredini - Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë - ZKM
  - 4) Gjergj Dedaj - zëvendësministër i MPMS-së
  - 5) Bujar Kadriu - Shoqata e të Verbërve të Kosovës (i verbër)
  - 6) Agim Hyseni - zëvendësministër i MASHT
  - 7) Agim Vatovci - Shoqata e Distrofisë Muskulore
  - 8) Shpend Tërdeva - zëvendësministër i MAPL
  - 9) Ramadan Gashi - Klubi "Dëshira" (aftësia e kufizuar mendore/psikiatrike)
  - 10) Mubera Mustafa - zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë
  - 11) Sabrije Zeqaj - Handikos (aftësia e kufizuar fizike)
  - 12) Adem Grabovci - zëvendësministër i MTPT-ës
  - 13) Hilmnjeta Apuk - Organizata njerëzitet e vegjël të Kosovës
  - 14) Faruk Kukaj - (aftësia e kufizuar e kombinuar)
  - 15) Shaqir Haxhaj - OPFAKOS (prindërit/anëtarët e familjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar)
  - 16) Boban Stanković - Shoqata për Persona me Aftësi të Kufizuar.

3. Zyra për Qeverisje të Mirë e ZKM-ës do të shërbejë si sekretariat për të zhvilluar dhe mirëmbajtur aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/46

Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), ndahen mjete financiare për vitin 2008 në vlerë prej 40.000 (dyzetmijë) Euro.
2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur është formalisht e vendosur në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, nëntor 2006, në bazë të kontributit të dakorduar vjetor, varësisht prej grupit (Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale) të vendeve të Evropës Juglindore.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga Fondi rezervë i Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Këshilli për Bashkëpunim Rajonal në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 10/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohen rekomandimet e grupit punues ndërqeveritar për kriteret e madhësisë së administratës komunale, sipas organogramit dhe tabelës numerike të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

**CAKTIMI I KRITEREVE PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE NË  
ADMINISTRATËN KOMUNALE**

**Përmbledhje ekzekutive**

Kosova gjendet në një fazë të tranzicionit politik, ekonomik e social dhe një numër i konsiderueshëm i kompetencave, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe legjislacionit që prekë kompetencat e komunave do të vazhdojnë të barten në institucionet e qeverive lokale, me qëllim të forcimit të aftësive të tyre operacionale. Për ushtrimin e kompetencave, sipas legjislacionit në fuqi, është domosdoshmëri, bilanci midis numrit të punëtorëve të Administratës komunale dhe numrit të qytetarëve të njësive administrative dhe territoriale.

Administrata publike duke përfshirë të dy komponentët përbërëse të saj (administratën shtetërore, dhe organet e vetëqeverisjes lokale), konsiderohet të jetë pjesa me dinamike e shtetit modern, derisa tashmë, është i njohur fakti që administrata lokale është e lartë në numrin e tyre dhe ka nevojë të theksuar që stafet komunale të ngrisin aftësitë dhe shkathtësitë e tyre menaxheriale e administrative.

Reformimi i administratës publike është proces kompleks në kuptimin e multisektorialitetit, diversitetit të nevojave dhe kapaciteteve, zhvillimit të rrethinës dhe kohës së nevojshme për tu realizuar. Kjo nënkupton fillimisht krijimin e parakushteve themelore për realizimin e decentralizimit konform standardeve bashkëkohore dhe demokratike dhe lidhet drejtpërsëdrejti me përshtatjen e administratës publike kushteve dhe rrethanave të reja të krijuara.

Qeveria e Kosovës, ka miratuar Strategjinë e Reformës së Administratës Publike dhe planin aksional të implementimit të strategjisë që parasheh veq tjerash edhe



rishikimin funksional dhe zhvillimin e legjislacionit përkatës për statusin e punonjësve në administratën vendore.

Qeveria e Kosovës, po ashtu, ka sponzorizuar paketën ligjore që rregullon strukturën e organeve të kuvendeve komunale, kuadrin e kompetencave, territorin e tyre dhe financimin e strukturave administrative. Këto ligje, tashmë janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Këto ndryshime, kanë bërë të domosdoshme që me nguti të trajtohet numri i shërbyesve civil, për të sjellur një ekonomizim të mirëfilltë, veqmas kur numri i komunave është shtuar, ashtu si dhe numri i kompetencave të tyre. Në të njëjtën kohë, Qeveria, synon, që ky proces të mbahet në kufijtë e tpeprueshëm buxhetor.

Njëkohësisht, ndryshimet e thella demografike pas viteve '99 kanë bërë që raporti në mes territorit dhe njeriut të ndryshojë dhe si pasojë e kësaj kemi një disblanc në trekëndëshin e territorit të një komune, numrit të popullsisë dhe administratës komunale.

Kuantifikimi i madhësisë së administratës lokale, sa është i nevojshëm, është kompleks dhe vështirë, njëtrajtshëm, për t'u aplikuar për të gjitha njësitë organizative komunale. Diversiteti, në madhësinë e tyre, shkallën e zhvillimit urban, arsimor, ekonomik, demografik, etnik, etj, e bën të rëndë që një forumlë e vetme, të jap zgjedhje ideale për të gjitha komunat.

Komponentë kryesore të funksionimit efikas të administratës së pushtetit lokal, gjithashtu, është edhe profesionalizmi i stafit të administratës komunale. Në lidhje me këtë, ndarja administrative territoriale, duhet të bëhet patjetër sipas kritereve që janë të përcaktuara në Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale. Kjo nënkupton që përjashtimisht, kujdesit për disiplinën fiskale, është në duart e menaxhmentit komunal, që të vendos për numrin, shkallën profesionale të të punësuarëve në administratë.

Nëse i bëjmë sot një analizë shërbimeve që ofrohen për kokë banori në komuna del se kemi një disproporcion total dhe figurativisht mund ta pasqyrojmë si vijon: derisa Novobërda ka të punësuar në administratën komunale numri i stafit administrativ shkon në drejtim të një (1) punëtor/e në 69 banorë, Komuna e Prizrenit, 1 punëtor/e ofron shërbime 711 qytetarë.

Ndarja e drejtë territoriale sipas kritereve të lartpërmendura është një instrument për të adoptuar më mirë raportin e qytetarit me territorin ku jeton, me administratën që ai zgjedh, dhe me një numër reformash sektoriale të ndëlidhurma ndërmjet vete me ndikimin e tyre.

Për këtë qëllim, Qeveria e Kosovës, ka themeluar një komision ndërministror me pjesëmarrje edhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, të cili i është vënë në

detyrë, që duke analizuar procesin vijues të reformës, në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe duke konsideruar qëllimin për shërbime më të mira për qytetarët, të bëj një propozim i cili do të përcaktonte kriteret për vendosjen e kufinjëve të resurseve humane në vend dhe në vazhdim që këto kriteret të mundësojnë një ndarje të drejtë në mes të komunave të Kosovës.

### **Propozimet në lidhje me kriteret e numrit të të punësuarve në administratën komunale**

Rregullat që përcaktojnë madhësinë e stafit komunal të administratës duke përfshirë stafin arsimor dhe stafin mjekësor, të cilat janë tashmë të njohura, përmes sistemit të një "grandi të hapur", të përcaktuar me ligjin e financave për pushtetin lokal, dhe formulave të FMN-së dhe Bankës Botërore që janë përvetësuar nga institucionet e Kosovës.

Stafi administrativ në fushën e shëndetësisë dhe arsimit është duke u trajtuar nga ministritë respektive, dhe është imediatike, që ky proces të përfundojë, para se komisioni i graveve të vendos shumat finale në numrin e stafit total komunal dhe buxhetin e tyre.

Shërbimet e kujdesit emergjent, janë trajtuar si kompetenca të deleguara, kështu që i takon ministrisë sektoriale, që të vendos standartizimin e numrit të stafit për zjarrfikësit dhe shërbimet tjera emergjente, ashtu siq duhet të ndaj resurse të nevojshme financiare për financimin e tyre.

Pra, në këtë studim, janë dhënë të gjitha shërbimet tjera administrative, përjashtimisht:

- Stafi i administratës së arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm dhe në shëndetësi

Propozimet për numrin e administratës në shëndetësi komunale dhe numrin e zjarrfikësve në komuna janë të ministrive respektive dhe të bazuara në aktet ligjore dhe nënligjore që i rregullojnë këto sektorë.

Studimi nxjerr në propozim dy (2) kriteret:

- (i) Kriteri bazë: - që të gjitha komunat pa marrë parasysh madhësinë e tyre, bazuar në obligimet që dalin nga legjislacioni për funksionimin e tyre u nevojitet stafi në kufirin minimal prej 55. Ky numër është preciz, sipas vendeve të punës dhe përshkrimit të detyrave që duhet të

bëjnë dhe autoritet komunale nuk mund t'i ri-alokojnë në fusha apo detyra tjera dhe tabela është dhënë në aneksin A të dokumentit.

(ii) Kriteri suplementar:

(a) Komunat e Republikës së Kosovës që kanë mbi 100.000 banorë, 1 punonjës administrativë të shërbejë për 620 qytetarë. (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan) që 1 punonjës administrate të shërbej për 1.000 qytetarë.

(b) Komunat tjera të Kosovës që kanë nën 100.000 banorë, 1 punonjës administrate do të shërbejë për 780 qytetarë.

Stafi i përlogaritur në kriterin suplementar, është në dispozicion të organeve përkatëse komunale, t'i alokojnë varësisht në qëllimet e politikave lokale komunale, prioritetet e tyre etj (aneksi B, bashkangjitur me këtë dokument).

Rekomandimet për veprimet e nevojshme:

- (i) Aprovimi i projekt-propozimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
- (ii) Informimi adekuat i inistitucioneve përkatëse lidhur me mënyrën e implementimit, impaktin dhe produktin final,
- (iii) Përcaktimi i periudhës transitore për implementimin e projekt-propozimit,
- (iv) Sigurimi i kostos shtesë buxhetore,
- (v) Shpërndarja e numrit total të punonjësve brenda administratës komunale të mbetet e drejtë e menaxhemntit të secilës komunë, varësisht nga prioritetet por se duhet të ruhet mesatarja e rrogave që parashihet me principet universale të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës,
- (vi) Brenda numrit të lejuar sipas këtyre kriterëve komunat duhet të respektojnë përbërjen gjinore dhe nacionale sipas rregullave në fuqi.
- (vii) Të gjitha komunave të cilave kriteri i ri u mundëson rritjen e stafit të administratës mbi numrin aktual rekomandohet, të mos aplikojnë rritjen e stafit, në mënyrë që numri total të sillet në kufijtë e tolerueshëm, më së paku për periudhën e ardhshme 20 mujore,
- (viii) Të analizohet mundësia që disa nga shërbimet të trajtohen si ndërmarrje publike komunale të vetfinancueshme dhe vetëm në raste

- të jashtëzakonshme të mund të subvencionohen nga buxhetet komunale
- (ix) Pas aplikimit të Ligjit për bashkupnim ndërkomunal, komunat të futen në aranzhmanet e nevojshme që mundëson që disa shërbime në emër të caktuar të komunave të kryhen nga një shërbim/qendër e përbashkët.

*Përparësitë dhe dobësitë në lidhje me propozimet*

*Përparësitë:*

- Këto kritere sjellin për të parën herë në historinë e re të planifikimit buxhetor të Kosovës, formula standarde me të cilat përcaktohet madhësia e administratës lokale;
- Sigurojnë shpërndarje të drejtë të shërbimeve në raport me numrin e qytetarëve;
- Eliminon disproporcionet aktuale në mes të komunave,
- Siguron kuantifikim të thjeshtë për buxhetbërësit dhe vendos politika të qëndrueshme në planifikimet afatmesme buxhetore, në pajtim me progresionin demografik,
- Siguron stabilitetin e administratës komunale duke krijuar mundësitë e planifikimit dhe ngritjes së kapaciteteve të resurseve humane.

*Dobësitë:*

- Në periudhën afatshkurtër sfidon disa nga organet komunale (që sipas përlllogaritjeve duhet të bëjnë shkurtime më të thella) për të zvogëluar stafin e tyre në një periudhën e ardhshme 20 mujore.
- Sfidon në përzgjedhjen e kritereve dhe analizave të nevojshme, për fushën dhe llojin e shkurtimeve të vendeve të punës,
- Që të sigurohet që është ruajtur niveli i nevojshëm i ekspertizës teknike në mënyrë që shërbimet për qytetarët nuk do të dëmtohen.

Bashkë me këtë prezentim të shkruar si pjesë përbërëse është dhënë tabela e nevojshme e cila për secilën komunë e cila përmban: (i) numrin zyrtar të qytetarëve, numrin zyrtar të komuniteteve pakicë, stafin minimal të determinuar nga korniza ligjore, numri i stafit bazuar në kriterin suplementar të propozuar, numrin e përgjithshëm, numrin e stafit aktual të lejuar me Ligjin vjetor të buxhetit 2008, numrin e stafit që duhet të shkurtohet apo rekrutohet varësisht nga komuna.

# ORGANOGRAMI I POZITAVE BAZË PËR KOMUNA

<p>Auditori i Brendshëm (1)</p>	<p>Zyrtar Prokurimi (1)</p>	<p>KRYETARI Zv. Kryetar Zv. Kryetar për Komunitete</p>	<p>ASAMBLEJA Kryesuesi Zv. Kryesuesi nga Komunitetet</p>
<p>Departamenti për Administratë &amp; Personel apo Shërbime të Përbashkëta(15+) DREJTOR</p>	<p>Departamenti për Ekonomi, Financa &amp; Zhvillim (13) DREJTOR</p>	<p>Departamenti për Arsim &amp; Kulturë (4+) DREJTOR</p>	<p>Departamenti për Planifikim Urban, Kadashtër &amp; Mbrojtje të Mjedisit (7) DREJTOR</p>
<p>Zyrtar për Logjistikë &amp; Pajisje</p>	<p>Shef Financiar, Zyrtarë për Buxhet(2)</p>	<p>NJËSIA për Arsim &amp; Buxhet</p>	<p>Inspektor Ndërtimi</p>
<p>Zyrtarë për Ceshitje Gjimore, Komunitete, Të Drejta të Fëmijëve (3)</p>	<p>Zyrtar Certifikues Arkëtar (2)</p>	<p>NJËSIA për Arsim</p>	<p>Inspektor për Mjedis &amp; Miniera</p>
<p>Menaxher për Personel Specialistë për Personel (2)</p>	<p>Zyrtar për Të Hyra, Regj. Pronësore, Tatime (3)</p>	<p>Shef Biblioteke</p>	<p>Zyrtar për Leje Ndërtimi</p>
<p>Zyrtar për Parashpresa</p>	<p>Zyrtar për Licencim Biznesi</p>	<p>Shefa për Kulturë, Rini &amp; Sport (3)</p>	<p>Zyrtarë për të dhëna të Kadastrave &amp; Kontrollor (3)</p>
<p>TI Specialist</p>	<p>Zyrtar për Pyltari &amp; Agrikulturë</p>	<p>NJËSIA për Teatër, nëse ka</p>	<p>Specialistë për Mirëqenie Sociale, Shëndetësi, Zyrtarë për Kujdes Social, Specialist për Pagesa Sociale, Strehim Social (4)</p>
<p>Përkthyes i Sekretarisë së Asamblesë (2)</p>	<p>Zyrtar për Turizëm &amp; Zhvillim Ekonomik</p>	<p><b>SHËNIM: TË GJITHA NJËSITË DUHET TË KENË të punësuar sipas Rregullave &amp; Standardeve të Ministrisë Asambleja NUK janë Pozita?</b></p>	<p>Menaxher dhe Specialist i Qëndës për Shërbim të Qytetarë (2)</p>
<p>Menaxher për Arkiv</p>	<p>Zyrtar për Integrim Evropian</p>	<p>Inspektor për Zejë, Transport, Biznes dhe Tregje (2)</p>	<p>NJËSIA e Inspektorëve për Zjarr</p>
<p>Zyrtar për Informim Publik</p>			

# KALKULIMET E POZICIONIMIT TË STAFIT KOMUNAL TABELAT E SKENARIT MASTER

L Daum 25 Shtator 08

VERSIONI 5: I Situar Personeli për Emergjencë dhe Shëndëtsi: Në Shëndëtsi është VETËM Staf Administrativ Qendror!

Popullata pa Personel për Arsimit Shëndëtsi dhe Shërbime Emergjente

1:750 Popullata për Komunitat me mbi 100,000

1:620 Popullata për Komunitat me nën 100,000

Komuna	Popullata Zyrtare	Popullata e Re	Nr Zyrtar i Ri për Popullatë Minoritet	Minimumi i Pozitave të Caktuara	Pozitat për Popullatë	Totali i Pozitave të Reja	Pozitat Aktuale	Diferenca	ZARRFIKËS			Stëndëtsi Staff Admin Qendror
									Profesion ishtë	Vullnetarë	Total	
Podujevë /Podujevo	117,000	117,000	735	55	156	211	195	16	54	12	66	10
Prishinë /Prishtina	400,000	388,561	4,961	55	518	573	529	44	156	23	178	23
Prizren /Prizren(Mamusha)	220,000	214,963	30,077	55	287	342	271	71	86	23	109	15
Gjakovë /Gjakovica	115,000	115,000	6,013	55	153	208	209	-1	54	12	66	10
Pejë /Peç	115,000	115,000	12,650	55	153	208	256	-58	54	12	66	10
Gjilan /Gjilane	110,000	100,348	4,058	55	134	189	216	-27	54	12	66	9
Ferizaj/Uroševac	111,000	111,000	3,367	55	148	203	202	1	54	12	66	10
<b>TOTALET E KOMUNAVE 1/750</b>	<b>1,188,000</b>	<b>1,161,872</b>	<b>61,861</b>	<b>385</b>	<b>1,549</b>	<b>1,934</b>	<b>1,888</b>	<b>46</b>	<b>511</b>	<b>106</b>	<b>617</b>	<b>86</b>
Glogovac /Glogovac	60,000	60,000	0	55	97	152	121	31	25	12	37	7
Fushë Kosovë /Kosovo Polje	35,000	33,682	3,730	55	54	109	128	-19	17	8	25	6
Lipjan /Lipjan	75,000	69,115	4,952	55	111	166	162	4	40	8	48	7
Obiliq /Obiçic	26,000	26,000	3,360	55	42	97	85	12	18	8	26	5
Shitër /Shitnje	28,000	28,000	560	55	45	100	74	26	17	8	25	5
Dragash /Dragas	35,000	35,000	12,935	55	56	111	106	5	25	12	37	6
Rahovec /Rahovac	63,000	63,000	1,953	55	102	157	138	19	31	12	43	7
Suharekë /Siva Reka	80,000	80,000	471	55	129	184	134	50	46	12	58	8
Mališevo /Mališevo	52,000	52,000	28	55	84	139	129	10	26	12	38	6
Decan /Decan(Junik)	50,000	40,400	294	55	65	120	104	16	25	12	37	6
Istog /Istok	44,000	44,000	2,646	55	71	126	123	3	25	12	37	6
Klinë /Klina	44,000	44,000	1,863	55	71	126	120	6	25	12	37	6
Leposaviq /Leposaviç	19,000	19,000	0	55	145	200	103	-97	17	8	25	5
Mitrovicë /Mitrovica	110,000	90,000	5	55	200	297	297	0	54	12	66	9
Skenderaj /Shtica	56,000	56,000	366	55	90	145	190	-45	26	12	38	7
Vushtri /Vuchtn	75,000	75,000	2,615	55	121	176	170	6	42	12	54	8
Zubin Potok /Zubin Potok	15,000	15,000	800	55	24	79	113	-34	17	8	25	5
Zegran /Zveçan	16,000	16,000	600	55	26	81	63	18	12	8	20	5
Kaçanik /Kaçanik(HIEIZ)	43,000	33,000	4	55	53	108	94	14	14	13	30	6
Kamenicë /Kamenica	55,000	49,581	4,670	55	80	135	155	-20	25	14	39	6
Novobërdë /Novo Brdo	5,000	9,899	2,785	55	16	71	67	4	9	16	25	5
Shitërcë /Štrpce	11,000	11,000	3,438	55	18	73	62	11	9	16	25	5
Viti /Vitina	51,000	46,458	293	55	75	130	138	-8	25	12	37	6
<b>TOTALI I KOMUNAVE 1/620</b>	<b>1,048,000</b>	<b>996,135</b>	<b>48,873</b>	<b>1265</b>	<b>1,607</b>	<b>2,872</b>	<b>2,876</b>	<b>-4</b>	<b>573</b>	<b>259</b>	<b>832</b>	<b>142</b>
Mamusha	0	6,000	0	55	0	55	19	36	9	16	25	5
Junik	0	9,600	0	55	0	55	18	37	9	16	25	5
Hani / Elezit	0	10,000	0	55	0	55	25	30	9	16	25	5
<b>TOTALI I PNJK-ve</b>	<b>0</b>	<b>25,600</b>	<b>0</b>	<b>165</b>	<b>0</b>	<b>165</b>	<b>62</b>	<b>103</b>	<b>27</b>	<b>48</b>	<b>75</b>	<b>15</b>
Gacanicë	0	18,642	2,670	55	0	55	0	55	14	8	22	5
North Mitrovicë/ Mitrovica	0	20,000	1,990	55	0	55	0	55	17	8	25	5
Kllokot	0	4,542	1,205	55	0	55	0	55	5	8	13	5
Ranilug	0	4,955	0	55	0	55	0	55	5	8	13	5
Panlesh	0	5,217	0	55	0	55	0	55	9	16	25	5
<b>TOTALI I KOMUNAVE TE REJA</b>	<b>0</b>	<b>53,356</b>	<b>5,865</b>	<b>275</b>	<b>0</b>	<b>275</b>	<b>0</b>	<b>275</b>	<b>50</b>	<b>48</b>	<b>98</b>	<b>25</b>
<b>TOTALET E MEDHA</b>	<b>2,236,000</b>	<b>2,236,963</b>	<b>116,599</b>	<b>2,090</b>	<b>3,156</b>	<b>5,246</b>	<b>4,826</b>	<b>420</b>	<b>1,161</b>	<b>461</b>	<b>1,622</b>	<b>268</b>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Mbështetet krijimi i Komitetit Ndërministror në lidhje me Programin për Zhvillimin e Politikave të Qëndrueshme të Punësimit.
2. Zëvendëskryeministri Ramë Manaj emërohet kryesues i Komitetit Ndërministror.
3. Kërkohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe nga Ministria e Shëndetësisë që të krijojnë grupe punuese për zbatimin e politikave të Programit për Zhvillimin e Politikave të Qëndrueshme të Punësimit.
4. Ministrinë, sipas pikës 3. të këtij vendimi, të caktojnë nga një koordinator për secilin grup punues.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 12/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik i lejohet rritja e numrit të personelit prej 18 (tetëmbëdhjetë) nëpunësve për të mbështetur aktivitetet e nevojshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
2. Mjetet financiare janë ndarë me vendim të Qeverisë Nr. 03/42 të datës 31.10.2008 nga Rezerva e Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI  
  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2009 - 2011.
2. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 14/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Gazin Natyror.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 15/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Zonat Ekonomike.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:  
- të gjitha ministrive (ministrave)  
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës  
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 16/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Projektligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 17/46  
Datë: 03.12.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 03 dhjetor 2008, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Rregullorja Nr. 01/2008 për Funkcionimin e Fondit për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta.
2. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit / Zyra për Informim Publik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë